

VENDIM
Nr.17, datë 28.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.193, DATË 20.3.2020, TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, “PËR DETAJIMIN E AKTIVITETEVE SIPAS NOMENKLATURËS SË AKTIVITETEVE EKONOMIKE”

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, të ndryshuar, Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 28.4.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së aktiviteteve të lejuara, sipas urdhrit nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike”, të ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMNISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama**

Lista e aktiviteteve të lejuara:

Lejohen	4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara
Lejohen	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara
Lejohen	4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara (Përfshirë dhe Tregtia me pakicë e Armëve dhe Municioneve, Artikujve Ushtarakë).
Lejohen	4932	Aktiviteti i taksive
Lejohen	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara
Lejohen	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara
Lejohen	9609	Aktivitete të tjera p.k.t
Lejohen	4759	Tregtia me pakicë e mobiljeve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t
Lejohen	4776	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara
Lejohen	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara
Lejohen	4743	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara
Lejohen	5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës
Lejohen	4753	Tregtia me pakicë e qylymave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dysHEMEVE në dyqane të specializuara
Lejohen	4765	Tregtia me pakicë e lojrave dhe lodrave në dyqane të specializuara

Lejohen	4763	Tregtia me pakicë e regjistruarve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara
Lejohen	4764	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara
Lejohen	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuar.